

VENDIM
Nr.23, datë 9.1.2008

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË PËRDORIMIT TË UJIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6, shkronja “a”, 57 e 72, të ligjit nr.8093, datë 21.3.1996 “Për rezervat ujore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për përdorimin e ujit, me leje apo koncesion, sipas tabelës I, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Të ardhurat e realizuara nga këto tarifa dhe nga pagesat për shpenzimet administrative për leje përdorimi të derdhen në Buxhetin e Shtetit.
3. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Financave dhe këshillat e baseneve ujëmbledhëse për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi nr.313, datë 21.5.2004 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e tarifave të përdorimit të ujit”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TABELA I : TARIFAT E PERDORIMIT TE UJIT

Nr.	QËLLIMI I PËRDORIMIT TË UJIT	PERDORUESIT	E DREJTA E DHENIES (Leje / Koncesion)	TARIFA (Lek/m³)	
				Ujë sipërfaqesor	Ujë nëntokësor
1	FUNIZIMI ME UJE				
1.1		Shoqëritë e ujësjellës kanalizime me prodhim uji deri në 10 milion m³/vit	Koncesion	0,05	0,08
1.2		Shoqëritë e ujësjellës kanalizime me prodhim uji 10 deri në 20 milion m³/vit	Koncesion	0,05	0,09
1.3		Shoqëritë e ujësjellës kanalizime me prodhim uji mbi 20 milion m³/vit	Koncesion	0,05	0,1
1.4		Familjet që nuk lidhen me rrjetin e funizimit me ujë të shoqërive të ujësjellës kanalizimeve.	Leje	-	1.1
1.5		Njësitë tregëtare dhe të shërbimit si restorante, hotele, etj.	Leje	-	35
1.6		Perdorim i ujit për pishina.	Leje	-	40
1.7		Subjektet e prodhimit të ujit të ambalazhuar të destinuar për pirje.	Koncesion	-	20
1.8		Industritë e prodhimit të pijeve alkoolike dhe jo alkoolike	Koncesion	-	2
1.9		Subjektet e eksportit të ujit të pa ambalazhuar	Koncesion	-	20
2.0		Ndërmarje industriale e shërbimi që përdorin ujin për proces teknologjik si metalurgji, çimento, lavazhe, perpunim mermeri , pasurim mineralesh, etj.	Leje	2	5
2	PESHKIMI				
2.1		Ndërmarrjet e prodhimit të rasatit të peshkut dhe akuakulturë në ujëra të ëmbla.	Leje	0.05	0.1
3	BANJAT TERMALE				
3.1		Shoqëri private	Leje	-	40
4	PRODHIMI I HIDROENERGJISË				
4.1		Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH)	-	1% e cmimit per cdo Kw të prodhuar	-
4.2		Shoqëri private të prodhimit të energjisë	Koncesion	1% e cmimit per cdo Kw të prodhuar	-